

AKT THEMELIMI DHE STATUT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “Athina Nova” shpk

KREU I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot më datë 13.01.2025 , në Tiranë, me cilësinë e ortakut themelues:

Znj. Teuta Vodo, e bija e Kristaq-it, qytetare shqiptare, lindur në Divjakë, Lushnjë, më 26.08.1984, me banim në Komuna Farkë, (Pallati NR. 5. SHK 1. AP 15 RR. HAMDË GARUNJA) 21006 ,Tiranë, me numer personal I45826025A;

kam vendosur me vullnet të lirë dhe bazuar në ligjin nr.9901, datë 14/04/2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, të themeloj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“Athina Nova” shpk**, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky Statut.

Neni 2

Emërimi

Shoqëria **“Athina Nova” shpk** (në vijim “Shoqëria”) krijohet si person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Shoqëria miraton dhe përdor logon, vulën, shumën e kapitalit të nënshkruar, NIPT-in dhe çdo të dhënë tjetër që e identifikon atë në mardhënie me të tretë.

Neni 3

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria **“Athina Nova” shpk** është një shoqëri tregtare, e krijuar sipas ligjit të shoqërive tregtare dhe si e tillë nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 4

Selia

Shoqëria e ka selinë në Lushnjë, **Divjakë, Lagjia e Xengut (Olive Guesthouse)**.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brënda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakut të vetëm .

Neni 5
Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të operojë në fushën e shërbimeve të konsulencës dhe këshillimit.

Neni 6
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Vendosja e mëpasshme e një kufizimi në kohë është kompetencë e mbledhjes së Ortakut të Vetëm të shoqërisë

KREU II
KAPITALI

Neni 7
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njëqind) lekë, ekuivalent me një 1 (një) kuotë.

Kapitali i mësipërm është nënshkruar nga Ortaku themelues

Znj. Teuta Vodo, zotëruese i 1(një) kuotë me vlerë të përgjithshme 100 lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 8
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për keto kontribute në natyrë sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim të Ortakut të Vetëm në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar me ligje apo të këtij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo personi interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mblidhet për të marrë vendim.



Neni 9
Transferimi i kapitalit

Kuatat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata mes paleve duhet të bëhet me shkrim.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 10
Organi Vendimmarrës

Ortaku i Vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Ortaku i Vetëm është organi vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyqruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Ortaku i vetëm, vendos për çështje si :

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë,
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve,
- c) investime,
- d) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.



Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të. Vendimet e ortakut janë të detyrueshme për zbatim nga ana e drejtimit të shoqërisë.

Neni 11 Administrimi

Administrator i shoqërisë emërohet **Teuta Vodo**, atësia Kristaq, shtetase Shqiptare, identifikuar me numër personal identifikimi I45826025A, e datëlindjes 26.08.1984, lindur në Divjakë, Lushnjë dhe banuese në Tiranë, me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.

Neni 12 Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme,
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare,
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë,
- d) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecursisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim,
- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë,
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit si dhe te publikoje cdo vendim që ka efekte për shoqërinë,
- g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë e juridike, publike dhe/ose private, vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj. Administratori është i detyruar të zbatojë vendimin e ortakut të vetëm, kjo edhe në rastet kur mendimi i tij është i ndryshëm

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 13
Përgjegjësitë

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaku i Vetëm që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare",

1. Administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis,
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita,
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim,
- d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë,
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) i kthen ortakut kontributet,
- b) i paguan ortakut interesa apo dividendë,
- c) i shpërndan aktivet shoqërisë,
- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet,
- e) jep kredi.

KREU IV
VITI FINANCIAR, BALANCI

Neni 14
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe mbyllet në 31 Dhjetor.



Neni 15
Bilanci i shoqërisë dhe dividendët

Mbledhja e Ortakut të Vetëm, miraton pasqyrat financiare të paraqitura nga Administratori. Mbledhja e Ortakut të Vetëm pas miratimit të pasqyrave financiare dhe në çdo kohë që e shikon të arsyeshme, vendos për shpërndarjen e dividendit apo krijimit të rezervave, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

KREU V
PRISHJA, LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Neni 16
Shpërndarja ose prishja e shoqërisë

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj,
- b) me vendim të ortakut të vetëm,
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit,
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit",
- e) me vendim të gjykatës,

Në këtë rast Ortaku i Vetëm merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesen shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku i Vetëm.

Nëse Ortaku i Vetëm nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 17
Likuidimi

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji.

Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit.



Neni 18
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij ne përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 19
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e rrethit Gjyqesor, Tiranë.

O R T A K U
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Athina Nova" shpk

TEUTA VODO

